

**UNIVERSITETI “ ISMAIL QEMALI “VLORE**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**Teme diplome për**  
**Master Shkencor në Shkenca Infermierore**  
**Viti 2021**

**TEMA: “ VLERËSIMI I LIDHJES MIDIS LARJES SË DUARVE DHE**  
**INFEKSIONEVE SPITALORE NË SPITALIN RAJONAL FIER “**

**DIPLOMANTI**  
**Daniela Mërtika**

**UDHEHEQËS SHKENCOR**  
**Prof.dok Petraq Mustaqe**

**VLORE**  
**SHTATOR, 2021**

**DEKLARATË**

Deklaroj se teza e titulluar “Vlerësimi i lidhjes midis larjes se duarve dhe infeksioneve spitalore në Spitalin Rajonal Fier” është puna ime origjinal.

**FIRMA:**

Daniela Mërtika

**DATE:** 10/09/2021

## **Abstrakt**

### **Hyrje**

Infeksionet spitalore janë mjaft të shpeshta ditët e sotme dhe janë ndër shkaqet kryesore të agravimit të shumë sëmundjeve që pacienti mund të ketë . Larja e shpeshtë dhe e rregullt e duarve nga ana e infermierëve është mjaft thelbësore në minimizimin deri në parandalimin e këtyre infeksioneve . Theksi do të vihet në njohuritë që kanë infermieret kanë rreth larjes së duarve edhe mundësive të tyre për realizimin e kësaj procedure.

### **Qëllimi i studimit**

Qëllimi i këtij studimi është të hulumtojë dhe të vleresojë rëndësinë që ka për infermierët zbatimin e protokollit të higjenës së duarve.

### **Metodologjia**

Studimi do të jetë I tipit deskriptivo-analitik, kros-seksional. Studimi u realizua në qytetin e Fierit ku u përzgjedh një kampion prej 100 infermieresh për studim. Përzgjedhja e infermierëve u bë në menyre rastësore. Të dhënat u mblodhën në periudhën Qershor-Korrik 2021 nëpërmjet një pyetësoi standart anonim të bazuar në literature. Përgjigjet e dhëna u përdoren thjesht për qëllime studimi dhe u ruajt anonimati.

**Rezultatet** Në bazë të rezultateve infermierët kryejnë sjelljet e duhura në funksion të higjenës së duarve. Vlera e koeficientit të korrelacionit ( $r= 0,796$ ), një koeficient i forte na tregon një marrëdhënie korrelacionale pozitive , statistikisht e rëndësishme ndërmjet njohurive të infermierëve dhe sjelljeve që ata kryejnë. Duke u bazuar te këto rezultate ajo që mund të themi është se sa më shumë njohuri të ketë një infermier në lidhje me higjenën e duarve aq më tepër mundësi ka ai të kryej sjelljet e duhura duke zbatuar me përpikmëri protokollin.

Në funksion të hipotezës së dytë, vlera e koeficientit të korrelacionit ( $r= 0,902$ ), një koeficient i fortë na tregon një marrëdhënie korrelacionale pozitive, statistikisht e rëndësishme ndërmjet mundësive që u ofrohen infermierëve dhe motivimit që ata marrin në punë. Pra ajo që mund të themi është se sa më shumë kushte, mundësi tu ofrohen në pavion infermierëve aq më të motivuar janë ata ta zbatojnë me përpikmëri protokollin e higjenës së duarve.

**Konkluzionet** Higjena e duarve është tepër e rëndësishme në parandalimin e infeksioneve spitalore. Mungesa e kohës në dispozicion dhe kushtet e papërshtatshme janë faktorë që ndikojnë negativisht në realizimin me sukses të higjenës së duarve. Pjesa më e madhe e infermierëve shprehen se protokollin e higjenës së duarve është i qartë , ata janë më të gatshëm për ta praktikuar kur motivohen nga eprorët, kolegët në njësinë ku ata punojnë. Edhe pse e konsiderojnë si të nevojshme infermierët nuk marrin shpesh pjesë në trajnime në lidhje me praktikatat e higjenës së duarve.

**Fjalet kyç** : larje e rregullt duarsh, parandalim infeksioni, pacient, pyetesor etj.

## **Abstract**

### **Introduction**

Nowadays nosocomial infection are very frequent and one of the main causes of many diseases a patient can have. Nurses should wash hands regularly, because it is vital for preventing these infections. Focus should be put into the knowledge that nurses have when it comes to hand washing and the circumstances under which nurses follow these procedure.

### **Aim of the study**

The aim of this study is to investigate and evaluate the importance of the application of hand hygiene protocol for nurses.

### **Methodology**

The research is of descriptive analytical and cross-sectional approach. It was conducted in the city of Fier where a sample of 100 nurses were randomly chosen for the study. Data was gathered from June up to July 2021 based on a standard questionnaire. Answers from the interviewees were used only for study purposes.

### **Results**

Based on the results, nurses have the adequate behavior in function to hand hygiene

Correlation coefficient value ( $r = 0,796$ ), a coefficient shows a positive correlation relation, statistically important about the knowledge that nurses have and the way they behave. Based on these results what we can say is that the more knowledgeable a nurse is on hands hygiene, the more are on the chances that he does the adequate behavior following the hospital protocol. In function to the second hypothesis, correlation coefficient value ( $r = 0,902$ ) a coefficient that shows a positive correlation relation, statistically important for the chances that nurses are offered and the motivation they have to work. So what we can say is that the better condition the in the hospital ward, more motivated are the nurse to follow the protocol.

### **Conclusions**

Hand hygiene is very important in preventing nosocomial infection. The lack of the time in disposal and inappropriate conditions are factors that affect negatively fulfilling hand hygiene. The majority of nurses say that hand hygiene protocols are clear to them, they are available to practice it when the errors and colleagues motivate them. Even though they consider it extremely important and necessary, nurses don't attend trainings that are related to hand hygiene.

**Keywords :** regular hand washing, infection prevention, patient questionnaire etc.

## Tabela e përmbajtjes

Hyrje .....	5
2.Shqyrtimi i literaturës .....	6
2.1 Historiku i higjenës së duarve.....	6
2.2 Përse duhen larë duart.....	7
2.3 Larja kirurgjikale e duarve.....	8
2.4 Studime .....	11
3.Metodologjia .....	13
3.1 Kampionimi .....	13
3.2 Si u përzgjedh kampioni .....	13
3.3 Instrumenti .....	14
3.4 Analiza e të dhënave .....	15
3.5 Limitet e Studimit .....	15
3.6 Çështjet ligjore dhe etike: .....	15
4. Rezultatet .....	16
5.Diskutime.....	46
6.Konkluzione.....	48
7.Rekomandime .....	50
8. Bibliografia .....	51
9.Apendix.....	52

## Hyrje

**LARJA E DUARVE** nënkupton pastrimin e duarve në kohën e duhur, në mënyrën e duhur dhe në vendin e duhur, bashkë me të gjitha masat e tjera të rëndësishme të parandalimit dhe kontrollit të infeksionit që kryhen në praktikën e përditshme të kujdesit shëndetësor.

Higjiena e duarve duket një masë e thjeshtë, por në mbarë botën problem të madh përbën mungesa e aderencës me udhëzimet për higjienë tek punëtorët shëndetësorë. Shumë strategji për promovimin dhe përmirësimin e higjienës së duarve janë dëshmuar si efikase tek institucionet shëndetësore anekënd botës. Tashmë është dëshmuar roli i adresimit të kompliansës së higjienës së duarve për pakësimin e infeksioneve të shkaktuara gjatë kujdesit shëndetësor.

Nga viti 2010 Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në kuadër të Sfidës të pare globale për siguri të pacientëve “Kujdesi i pastër është kujdes i sigurt” e caktoi **5 majin si OBSH Dita e higjienës së duarve: SHPËTONI JETË, Pastroni duart.**

Çdo vit me qindra miliona njerëz në botë përballen me infeksione intrahospitale. Në mbarë botën, për çdo ditë vdesin njerëz nga infeksione të fituara gjatë pranimit të kujdesit shëndetësor.

Veçanërisht të rrezikshme janë infeksionet intralospitale të cilat i shkaktojnë mikroorganizma multirezistent. Përdorimi i tepruar dhe i panevojshëm i antibiotikëve, sidomos atyre me spektër të gjerë të veprimit, tek bakteret ndikon në zhvillimin e rezistencës ndaj antibiotikëve dhe në këtë mënyrë e zvogëlon fuqinë e tyre për të vepruar atëherë kur më së shumti janë të nevojshëm. Përhapja e mikroorganizmave multirezistente në institucionet shëndetësore ndodh shpesh dhe në të shumtën e rasteve kjo gjë është si pasojë e duarve të papastrta të punonjësve shëndetësor, pacientëve dhe vizitorëve; pajisjeve të papastrta dhe nga mjedisi ku qëndron pacienti. Duart janë mënyra më kryesore e përhapjes së mikroorganizmave gjatë realizimit të kujdesit shëndetësor. Si pasojë të kësaj mund të kenë infeksione të rënda, sidomos tek pacientët që vuajnë nga ndonjë sëmundje e rëndë, pastaj kjo do e zgjasë qëndrimin e pacientit në spital, mund të shkaktojë invaliditet, ngarkesë financiare për pacientët dhe familjet e tyre, ngarkesë financiare për sistemin shëndetësor, dhe mbi të gjitha – shuarjen e jetës të një individi.

Për këtë arsye, zbatimi i masave të standardizuara të kujdesit, gjatë gjithë kohës dhe për të gjithë pacientët, është një faktor kyç për parandalimin e përhapjes të të gjithë mikroorganizmave, sidomos atyre multirezistente. Higjiena e duarve është një nga standardet themelore të kujdesit. Numri më i madh i infeksioneve intrahospitale mund të parandalohen thjesht duke zbatuar një higjienë të mirë dhe të drejtë të duarve. Çdo nivel më i lartë i higjienës së duarve zvogëlon rrezikun nga infeksionet intrahospitale për 24%.

Çdo punonjës shëndetësor, si dhe çdo person i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi është i përfshirë në kujdesin e të sëmurëve, duhet t'i kushtojë kujdes higjienës së duarve dhe ta praktikojë atë në mënyrën e duhur.

## **2.Shqyrtim Literature**

### **2.1Historiku i higjienës së duarve**

Shekuj me rradhë larja e duarve me ujë dhe sapun vlerësohej si masë e rëndësishme e higjienës personale. Ajo zbatohet si pjesë e riteve fetare tek shumë religjione. Por, lidhmëria ndërmjet përhapjes së sëmundjeve dhe higjienës së duarve është vënë pikërisht gjatë viteve të fundit. Hipokrati, mjeku më i njohur i antikës la porosinë: “Kurrënjëherë, askujt mos i shkaktoni dëm”. Edhe pse të gjithë mjekët sot japin Betimin e Hipokratit, ata shpesh harrojnë se duke mos i pastruar duart i shkaktojnë dëm pacientit. (1)

Në vitin 1825 farmacisti francez Labarak dëshmoi për dobinë që sillte fërkimi i duarve me tretje të klorit për mjekët dhe vizitorët e pacientëve me sëmundje ngjitëse. Në mesin e shekullit XIX, ndër shkaqet kryesore të vdekshmërisë së lehonave të reja ishte sepsa. Në vitin 1843 Oliver Holms në Boston hulumtoi shkaqet e kësaj sëmundjeje dhe gjeti se kjo sëmundje përhapej tek gratë përmes duarve të mjekëve dhe infermierëve. Shumë më vonë u kuptua se kjo sëmundje shkaktohej nga bakteret e gjinisë Streptococcus. Më 1847 obstetri hungarez Injaz Semelvajs rekomandoi pastrimin e duarve me ujë klorik për parandalimin dhe reduktimin e incidencës së etheve të lehonisë në dy repartet e lindtores së spitalit të Vjenës. Semevlajs vërejti se vdekshmëria e lehonave, të cilat lindnin në repartin e parë ishte katërfish më e lartë. Në këtë repart punonin mjekët dhe studentët e mjekësisë, të cilët paraprakisht vinin në lindtore drejt nga sallat e autopsisë, kurse në repartin e dytë lindjet kryheshin nga infermieret. Pasi që asokohe ende nuk dihej për ekzistimin e mikroorganizmave, Semelvajsi fajësoi “substancat kadaverike” si shkaktarë të infeksionit të lehonave dhe vdekshmërisë së lartë. Pas intervenimit në repartin e parë me pastrim obligativ të duarve me ujë klorik vdekshmëria u zvogëlua menjëherë. (2)

Në vitin 1863 Florens Nightigale publikoi librin e saj “Notes on hospitals”, në të cilin raportoi shkallën e vdekshmërisë në spitale duke argumentuar se ushqimi i sigurt, uji dhe ambienti i pastër reduktojnë sëmundjet kryesore dhe shpëtojnë jetëra. Gjatë shërbimit të saj në spitalin ushtarak britanik në Krimea ajo dëshmoi se ushtarët shumë më tepër vdisnin nga infeksionet spitalore, sesa nga plagët e marra në fushëbetetja. Jozef Listeri, më 1867, duke u bazuar në idenë e Lui Pasterit se mikrobet përveqse shkaktojnë fermentim, ato mund të japin edhe qelbëzimin e plagëve, filloi përdorimin e sprejëve antiseptikë me përbërje të acidit karbolik në sallat e operacionit për të parandaluar shfaqjen e infeksioneve në plagët kirurgjike. Dezinfektimi i parë kirurgjik i duarve me alkool dhe tretje të sublimatit u aplikua në Berlin më 1888 nga Paul Furbringer. (3)

Në vitin 1889 kirurgu W.S. Halsted sugjeroi përdorimin e dorëzave për ekipin kirurgjik, pasi që u konstatua se duart nuk mund të pastrohen plotësisht nga bakteret. Zbulimi i antibiotikëve në mesin e shekullit XX krijoi një ndjenjë të rrejshme të sigurisë ndaj mikrobeve, që u përcoll me zbehjen e rolit të higjienës dhe dezinfektimit në praktikën klinike. Zvogëlimi drastic i vdekjeve të shkaktuara nga sëmundjet ngjitëse gjatë shekullit të kaluar iu mvesh edhe instalimit të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit në institucione shëndetësore, që përmirësuan edhe infrastrukturën e higjienës së duarve. Në vitin 1961 në SHBA u incizua një film dokumentar që demonstronte teknikat e higjienës së duarve nga puntorët shëndetësorë. Kurse, në vitin 1975 e 85, u publikuan për herë të parë rekomandimet e higjienës së duarve në institucionet shëndetësore nga Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve (CDC) e SHBA: përmbledhja e fundit dhe më e përditësuar e këtyre rekomandimeve është dhënë në vitin 2002 ng John Boyce dhe Didier Pittet. (4)

## 2.2 Përse duhen larë duart


Mikrobet janë kudo, ato mund të spostohen lehtë nga një pikë në një tjetër duke përdorur ujin, objekte, gjallesat dhe grimcat e pluhurit, si një mjet për t'u transportuar, duke u riprodhuar në një shkallë alarmante. Gjatë ditës, duart tona janë në kontakt me shumë objekte, të tilla si kartëmonedha, prekje në transportin publik, dorezat e dyerve, dhe të tjera mbi të cilat janë të fshehura miliona mikroorganizma, disa prej të cilave kanë aftësi patogjene. Po t'i referohemi disa shembujve si gripit të zakoshmës, toxoplazmozës, konjunktiviti, infeksionet e zakonshme të zorrëve, ose më të fundit ardhur nga gripit A/H1N1: sipas ekspertëve, është e mjaftueshme larja e duarve tuaja çdo herë që dilni nga një tualet apo manipuloni ushqime, trajtuar apo prekur plagët, vendosjes apo heqjes së lenteve të kontaktit, shfryrjes së hundëve, kollitjes ose teshtitjes, trajtimin të mbeturinave, pas qëndrimit në ambjent me shumë njerëz, si në sallat e pritjes në hekurudha, aeroporte apo autobus, trena dhe kështu me radhë, për të reduktuar në mënyrë të konsiderueshme rrezikun e infeksionit. (5) Gjithashtu, këto mikrobe mund të hyjnë në trup kur duart hashtu, këto mikrobe mund të hyjnë në trup kur duart i çojmë në hundë, gojë, sy, edhe pse janë të padallueshme me sy të lirë për njeriun. Për më tepër, disa baktere kanë shfaqur edhe një rezistencë të fortë ndaj antibiotikëve dhe për këtë arsye është e rëndësishme parandalimi i infeksionit duke i larë duart tuaja tërësisht, veçanërisht për personat me një sistem të dobësuar imunitar (një ftohje banale mund të komplikohet në një bronkit kronik). Është mjaft e rëndësishme që gjithkush ta kthejë në zakon larjen e duarve, në dukje një veprim shumë i thjeshtë, por që mund të ndodhë të mos i kushtohet vëmendja e duhur. Sidomos duhet punuar me fëmijët që në vogëli për të fituar këtë zakon sa të thjeshtë aq të dobishëm. Shumë shpërthime sëmundjesh me origjinë nga ushqimet shkaktohen nga duart e palara. Prania e baktereve, viruseve që ndodhen në duart tona mund të shkaktojë grip, HIV e shume semundje te tjera

### **Kur duhen lare duart , 5 etapat e larjes se duarve**

Sa i përket mbështetjes dhe promovimit të higjienës së duarve dhe përmirësimit të shërbimeve në institucionet shëndetësore në mbarë botën, OBSH publikoi Udhëzuesin për higjienën e duarve në Institucionet shëndetësore. (6) Janë theksuar 5 momente kur higjiena e duarve duhet të realizohet pa dallim nëse përdoren apo jo doreza për një përdorim:

1. Para kontaktit me pacientin
2. Para kryerjes së veprimeve për pastrim
3. Pas rrezikut nga ekspozimi ndaj lëngjeve trupore
4. Pas kontaktit me pacientin
5. Pas kontaktit me mjedisin ku qëndron pacientit





### 2.3 Larja kirurgjikale e duarve

**Larje kirurgjikale e duarve** ka qenë një rutinë e detyrueshme për më pak se 150 vjet. Ky pastrim kërkon të eliminojë sa më shumë mikroorganizma të dëmshëm të pranishëm në duar dhe parakrahë përpara se të kryejë një operacion kirurgjikal. Deri në mes të shekullit të 19-të, larja e duarve nuk ishte një praktikë rutinë.

#### Qëllimi i larjes kirurgjikale të duarve

Objektivi kryesor i larjes kirurgjikale të duarve është minimizimi i ngarkesës së mikrobeve (sidomos baktereve) që mund të gjenden në lëkurën e duarve dhe krahëve të ekipit kirurgjikal.

Disa njerëz vënë në dyshim rëndësinë e larjes së duarve pasi që kirurgët mbajnë doreza. Sidoqoftë, këto doreza latex janë të brishta dhe nganjëherë mund të paraqesin pore mikroskopike që, megjithëse nuk lejojnë kalimin e gjakut dhe lëngjeve të tjerë, përbëjnë një derë të shkëlqyeshme për mikrobet që jetojnë në lëkurën e kirurgut. Përveç kësaj, ekziston rreziku që një dorezë të shkëputet nga çdo shkak: nga defektet e prodhimit deri te prerjet aksidentale me material të mprehtë. Për shkak të sa më sipër, jo vetëm që është e rëndësishme larja kirurgjikale e duarve, por është gjithashtu linja e parë e mbrojtjes në luftën kundër infeksioneve postoperative.<sup>(7)</sup>

Dihet gjerësisht se mikroorganizmat saprofitikë jetojnë në lëkurë, por në rastin e personelit të kujdesit shëndetësor, bakteret dhe kërpudhat patogjene (të afta të shkaktojnë infeksione) gjithashtu mund të gjenden që, megjithëse nuk i prekin ato drejtpërdrejt, mund të transmetohen tek pacientët. Prandaj vihet theksi te rëndësia e larjes së duarve para dhe pas vlerësimit të pacientëve, duke qenë veçanërisht e rëndësishme në rastin e procedurave invazive siç është operacioni.

Pittet (2001) gjatë vëzhgimit të infermierëve ka identifikuar disa nga faktorët që ndikojnë negativisht në zbatimin e protokollit të higjenës së duarve. Sipas tij mungesa e stafit, ngarkesa e madhe në punë, kohë e pamjaftueshme, acarimi i lëkurës, mungesa e informacionit dhe besimi se përdorimi i dorashkave shmang nevojën për higjenën e duarve janë ndër faktorët kryesorë. (8)

Sjellja individuale ndikon në zbatimin e protokollit të higjenës së duarve. Gjetjet e studimit të Trunell dhe White.J(2005), pas një vëzhgimi të praktikës së higjenës së duarve dëshmuar se 40% e punonjësve të kujdesit shëndetsor zbatojnë rregullat e higjenës së duarve. (9)

Kurvinen & Routamaa(2006) zbuluan se pavarësisht se sjellja individuale është e vështirë të ndryshohet ajo mund të përmirësohet me kalimin e kohës nga kolegët , eprorët. (10)

## **Procesi**

Larja kirurgjikale e duarve duhet të zgjasë rreth 5 minuta. Kjo është e standardizuar dhe duhet të bëhet gjithmonë në të njëjtën mënyrë dhe duke ndjekur të njëjtën sekuencë. Më poshtë përshkruhet procedura hap pas hapi për larjen kirurgjikale të duarve:

- Hapni furçën kirurgjikale.
- Thith atë në një solucion antiseptik (nëse furça nuk është më e zhytur në të).
- Ndizni ujin.
- Vendosni duart nën çezmën me majat e gishtërinjve drejt tavanit dhe bërrylat drejt fundit të lavamanit.
- Lëreni ujin të rrjedhë për të lagur të gjithë lëkurën e gishtërinjve, duarve dhe parakrahëve; uji duhet të kullojë nga gishtat në bërryla.


## **Larja e thjeshtë e duarve me uje e sapun**

Pastrimi i thjeshtë i duarve - Gjatë pastrimit të thjeshtë të duarve, duhet që së paku 10 sekonda të fërkohet mekanikisht gjithë sipërfaqja e duarve të shkumëzuara me sapun të thjeshtë me teknikë të definuar.(11) Pastaj duart shpërlahen nën vrushkullin e ujit dhe teren me palomë. Nëse s'ka ujë rrjedhës, përdoret shishe e pastër me ujë.

Shishja (ose vazoja) duhet të pastrohet dhe uji ndërrohet pas çdo përdorimi. Po ashtu, si alternativë mund të përdoret një kazan i ngritur lart dhe i pajisur me çep. Në mungesë të palomave, mund të përdoren edhe peshqirat, mirëpo ata nuk bën të përdoren kolektivisht dhe pas përdorimit ata duhet të hudhen në qeskën e larjes në lavatore.

Nëse furnizimi me ujë është jo i rregullt, në ato vende preferohet që uji të deponohet në enë të mëdha. Uji nuk duhet të përmbajë agjensë infektive

## SI T'I LANI DUART?



### Larja e duarve me uje e sapun

#### Pastrimi higjienik ose fërkimi me alkool behet ne keto raste:

- Para dhe pas përkujdesjes ndaj të sëmurit,
- Para kryerjes së procedurave invazive,
- Para përkujdesjes për të sëmurët e ndieshëm në infeksion (p.sh. ata që kanë imunitet të komprometuar),
- Para dhe pas përpunimit të plagëve, kateterëve urinarë dhe pajisjeve të tjera qëndrimgjata
- Para dhe pas bartjes së dorëzave,
- Pas kontaktit me gjak, sekrete dhe pas procedurave në të cilat pritet kontaminim me mikroorganizma,
- Pas kontaktit me të sëmurët që janë të kolonizuar me mikroorganizma patogjenë. Spitalorë (siç janë S. aureus rezistent në meticilinë, Klebsiella mulirezistente). Metoda

më efikase dhe më shpejtë e dekontaminimit të duarve është fërkimi i tyre me alkool, mundësisht prej enës së veçantë që ndodhet pranë shtratit të të sëmurit.

- Para të gjitha ndërhyrjeve kirurgjike



## 2.4 Studime

Më poshtë do të paraqesimi disa gjetje interesante nga disa studime aktuale

Kelcikova et al (2012) arritën në përfundimin se edukimi i higjenës së duarve është një kontribues i rëndësishëm në parandalimin e infeksioneve . Sipas Kelcikovës (2012) pa edukimin e duhur të kryerjes së higjenës së duarve asnjë nga teknikat nuk mësohet në mënyrë korrekte. Ai shprehet se të marrësh njohuritë e duhura mbi diçka aq të thjeshtë sic është dhe larja e duarve ka potencialin për të parandaluar shumë infeksione. (13)

Një studim i realizuar në 2018-2019 kishte si qëllim të përcaktonte perceptimet e infermierëve të njësisë të kujdesit intensive në lidhje me higjenën e duarve. U morr një kampion prej 700 infermierësh (N=700). Mjetet e grumbullimit të të dhënave, duke përfshirë një pyetësor mbi karakteristikat demografike dhe profesionale, dy pyetësorë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë mbi njohuritë dhe perceptimin e higjenës së duarve, dhe pjesa e dytë e pyetësorit të KAP -it në lidhje me qëndrimin ndaj higjenës së duarve, u janë dhënë të gjithë punonjësve infermierë duke iu referuar njësive të kujdesit intensiv , në mënyrë që ata t'i përfundojnë ato dhe të japin rezultatet. Analiza e të dhënave u krye duke përdorur programin statistikor SPSS, versioni 20. Nga të gjithë punonjësit e infermierisë që morën pjesë në studim, 56.6% kishin njohuri të mira për higjenën e duarve, 71.3% një qëndrim të paanshëm ose neutral ndaj kësaj praktike dhe 64.5% një perceptim të lartë të saj. Një marrëdhënie statistikisht e rëndësishme u mor midis dijes dhe arsimit ( $P = 0.029$ ), perceptimit dhe moshës ( $P = 0.002$ ), përvojës së punës ( $P = 0.029$ ) dhe lagjes së vendit të punës ( $P = 0.014$ ). Si konkluzion u arrit në përfundimin se higjena e duarve është tepër e rëndësishme në parandalim të infeksioneve si dhe është gjithashtu e nevojshme të identifikohen faktorët që ndikojnë në promovimin e perceptimit dhe qëndrimin pozitiv midis punonjësve të infermierisë në lidhje me higjenën e duarve. (14)

Mohammed AL Mohaithef (2020) realizoi një studim qëllimi i të cilit ishte të vlerësojë praktikën e higjienës së duarve midis infermierëve që punojnë në spitale në Mbretërinë e Arabisë Saudite. Ai mori një kampion prej 300 infermierësh (N=300). Studimi zbuloi se 65.4% e pjesëmarrësve ndjekin një praktikë të mirë të higjienës së duarve. Gjithashtu ata infermierë që tregohen më korrektë në zbatimin e protokollit të higjienës së duarve janë femra. (15)

Higjiena e duarve është masa më e thjeshtë dhe më efektive për parandalimin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor. Megjithë thjeshtësinë e kësaj procedure higjiena e duarve është shumë e ulët sipas përfundimeve të Sands. M(2020) pas realizimit të një ankete me infermierë në disa spitale amerikane. Për studiuesit ishte e rëndësishme të kushtohet vëmendje edhe disa faktorëve që shpesh lihen në harresë siç janë siguria në punë, niveli i edukimit stresi etj. Nëse krijojmë në punë një klimë me një frymë positive duke larguar stresin infermierët do të jenë në gjendje të përmirësohen. (16)

### 3. Metodologjia

#### 3.1 Prezantimi i studimit

##### Qëllimi

Qëllimi i këtij studimi është të hulumtojmë dhe të vlerësojmë rëndësinë që ka për infermierët zbatimin e protokollit të higjenës së duarve.

##### Objektivat

Të identifikojmë njohuritë që zotërojnë infermierët në lidhje me higjenën e duarve.

Të vlerësojmë kushtet dhe mundësitë që u ofrohen infermierëve për të zbatuar me përpikmëri protokollin e higjenës së duarve.

Të identifikojmë sjelljet që kryejnë infermierët në funksion të protokollit të higjenës së duarve.

Shprehjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve për tu ardhur në ndihmë infermierëve për të përmirësuar sjelljet e tyre dhe për të vlerësuar rëndësinë e këtij procesi.

##### Lloji i studimit

Studim *deskriptivo-analitik*, Kros-seksional

##### Hipotezat

**Hipoteza 1** => Sa më tepër njohuri të kenë infermierët në lidhje me higjenën e duarve aq më të prirur janë ata të kryejnë sjelljet e duhura në zbatim të protokollit.

**Hipoteza 2:** => Sa më tepër kushte dhe mundësi tu ofrohen infermierëve aq më të motivuar janë ata të zbatojnë me përpikmëri protokollin e higjenës së duarve.

#### **3.2 Kampioni dhe procedura e përzgjedhjes së tij**

Ky studim u realizua në qytetin e Fierit, ku u përzgjedh një kampion prej 100 infermierësh në spitalin rajonal të këtij qyteti.

Së pari u morr një informacion i detajuar për pavionet dhe numrin e infermierëve që ofrojnë shërbim në këtë spital.

Përzgjedhja e infermierëve që morrën pjesë në këtë studim u bë në mënyrë rastësore.

18% e kampionit ishte pjesë e pavionit të kirurgjisë, 11% e tyre u përzgjedh në pavionin e patologjisë. Ndërkohë që infermierët në urgjencë përbën 28% të kampionit. Në të njëjtën % përkatësisht 28% u morrën edhe nga pediatria. 5% ishin pjesë e ORL-së dhe pjesa e mbetur konkretisht 10% nga infektivi.

Së fundmi në rast se një infermier nuk dëshironte të ishte pjesë e këtij studimi zëvendësohej me një infermier tjetër.

Përgjigjet e dhëna u përdorën thjesht për qëllime studimi dhe u ruajt anonimati. Në pyetësor nuk kërkohej identiteti i infermierit.

### **3.3Instrumenti**

Instrumenti i përdorur në këtë studim është **COM-B Hand Hygiene Behaviour Questionnaire**

Autorë të këtij pyetësori janë Paul O'Connor dhe Sinead Lydon

Qëllimi i këtij pyetësori është të identifikojë faktorët që ndikojnë në sjelljet që infermierët kryejnë në zbatim të protokollit të higjienës së duarve.

Përpara se infermierët të plotësonin këtë pyetësor atyre u kërkuua një informacion në lidhje me disa të dhëna socio- demografike.

<b>Të dhënat demografike</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Lloji i variablave</b>
Pavioni	Njësia ku u bë përzgjedhja e infermierëve	Variabël nominale
Eksperiencia në punë	Përvoja e tyre në punë, në vite	Variabël ordinale
Niveli arsimor	Vitet e edukimit në shkollë	Variabël ordinale

Ndërkohë që pyetësori synonte të maste 4 fusha:

- Njohuritë
- Mundësitë
- Motivimin
- Sjelljen

Për secilin pohim të secilës fushë ata duhet të qarkonin një nga numrat e një shkalle që varioonte si mëposhtë.

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>
Plotësisht jo dakord	Jo dakord	Deri diku dakord	Dakord	Plotësisht dakord

### **Besueshmëria**

Besueshmëria e këtij instrumenti është e lartë pasi ka një koeficient  $\alpha = 0,983$ .

### **Faza e pilotimit**

Përshtatja e instrumentit në gjuhën shqipe u realizua nga dy persona . Pas përcaktimit të variantit përfundimtar ky instrument u pilotua te 10 infermierë për të parë shkallën e kuptueshmërisë së

tij. Përsa i përket pyetësorit vetëm një infermier nga dhjetë kishin probleme të vogla me kuptueshmërinë e tij .

### **3.5 Analiza e të dhënave**

Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët u futën në një bazë të dhënash duke përdorur paketën statistikore, SPSS 25.

Të dhënat u futën në bazën e të dhënave nga një person i vetëm.

Analiza e të dhënave konsistonte në një analizë deskriptive të realizuar nëpërmjet programit SPSS, duke llogaritur :

- frekuencat
- mesataret
- përqindjet
- crosstabulimet

Statistika e përfshirë në këtë program bazë është korrelacioni.

### **3.6 Limitet e studimit**

- Ky studim u përqëndrua vetëm në spitalin rajonal të qytetit të Fierit.
- U përzgjedh një kampion prej 100 infermierësh, një numër relativisht i vogël për të përgjithësuar rezultatet për gjithë popullatën.
- Instrumenti i përdorur është i pastandartizuar për kulturën tonë.

### **3.7 Çështje ligjore dhe etike**

- Marrja e lejes specifike për realizimin e studimit
- Ruajtja e kofidencialitetit
- Realizimi i detyrës për qëllime studimi



## 4 Rezultatet

### 4.1 Karakteristikat e kampionit

Në këtë studim morren pjesë 100 infermierë, të cilët u përzgjedhën në disa pavione në Spitalin Rajonal të qytetit të Fierit.

Për të patur një kampion sa më përgjithësues dhe një larmishmëri në përgjigje u vendos që të merreshin infermierë nga disa pavione

		pavioni i infermiereve			
		Frekuenza	Percentuale	Percentuale valida	Percentuale cumulativa
Valido	kirurgji	18	18,0	18,0	18,0
	patologji	11	11,0	11,0	29,0
	urgjence	28	28,0	28,0	57,0
	pediatri	28	28,0	28,0	85,0
	orl	5	5,0	5,0	90,0
	infektiv	10	10,0	10,0	100,0
	Totale	100	100,0	100,0	

*Tabela 1: Pavioni i infermiereve*

Të dhënat e paraqitura në tabelë dhe në grafikun e mëposhtëm na demostrojnë se 18% e kampionit ishte pjesë e pavionit të kirurgjisë, 11% e tyre u përzgjedh në pavionin e patologjisë.


Ndërkohë që infermierët në urgjencë përbën 28% të kampionit.

Në të njëjtën % përkatësisht 28% u morrën edhe nga pediatria.

5% ishin pjesë e ORL-së dhe pjesa e mbetur konkretisht 10% nga infektiv.

Për të patur një panoramë më të qartë rezultatet e tabelës së mësipërme janë paraqitur edhe në mënyrë grafike.

Grafiku



*Grafiku 1: Pavioni i infermierëve*


Infermierët e përzgjedhur në këtë studim u pyetën në lidhje me nivelin e tyre akademik.

**niveli akademik**

		Frequenza	Percentuale	Percentuale valida	Percentuale cumulativa
Valido	bachelor	27	27,0	27,0	27,0
	master profesional	34	34,0	34,0	61,0
	master shkencor	39	39,0	39,0	100,0
	Totale	100	100,0	100,0	

*Tabela 2: Niveli akademik*

Në bazë të të dhënave informohemi se 27% e infermierëve janë të nivelit bachelor, 34% me master profesional dhe pjesa më e madhe e tyre, përkatësisht 39% janë me master shkencor.



*Grafiku 2: Niveli akademik*


Infermierët kishin vite të ndryshme eksperience në punë.

**eksperienca ne pune**

		Frequenza	Percentuale	Percentuale valida	Percentuale cumulativa
Valido	nen 5 vite	39	39,0	39,0	39,0
	5-10 vite	22	22,0	22,0	61,0
	11-15 vite	18	18,0	18,0	79,0
	mbi 15 vite	21	21,0	21,0	100,0
	Totale	100	100,0	100,0	

*Tabela 3: Eksperienca në punë*

39% e infermierëve të përzgjedhur për të qenë pjesë e këtij kampioni kishin nën 5 vite përvojë në punë, 22% kishin 5-10 vite eksperiencë. 11-15 vite përbënin 18% e kampionit dhe mbi 15 vite në punë kishin 25% e kampionit.



*Grafiku 3: Eksperienca në punë*

### **Analiza e besueshmërisë Cronbach' s Alpha**

**Statistiche di affidabilità**

Alpha di Cronbach	N. di elementi
,983	22

*Tabela 4: Alpha Cronbach*

Analiza e besueshmërisë Cronbach's Alpha është një analizë statistikore e cila përdoret në teste për të verifikuar qëndrueshmërinë e pyetësorit, sa ngushtësisht të lidhura janë me njëra-tjetren pyetjet e pyetësorit.

Koeficienti Alpha merr vlerë nga -1 në 1. Sa më afër 1-shit të jetë kjo vlerë aq më i besueshëm është pyetësori.

Nga rezultatet e paraqitura në tabelën e mësipërme, analiza e besueshmërisë ose e qëndrueshmërisë tregoi se instrumenti Hand Hygiene Behaviour Questionnaire kishte një Cronbach's Alpha të lartë  $\alpha = 0.98$

## Të dhënat përshkruese të variablave

Statistiche descrittive					
	N	Minimo	Massimo	Media	Deviazione std.
higjenaeduarve	100	33,00	110,00	67,2800	21,83690
Numero di casi validi (listwise)	100				

*Tabela 5 : Të dhënat përshkruese të variablave*

Ajo që vihet re nga tabela është se në lidhje me instrumentin, pikët minimale janë 33 kurse ato maksimale janë 110 , me një mesatare 67.28 dhe një devijim standart 21.83 Këto të dhëna tregojnë se ka një variacion të lartë pikësh . Ata infermierë që kanë pikë mbi mesataren janë më të prirur ti zbatojnë me përpikmëri rregullat për higjenën e duarve.

Në grupin e pyetjeve të mëposhtme do të marrim informacion për njohuritë që infermierët zotërojnë në lidhje me higjenën e duarve.

### Njohuritë


1a) Në pavionin ku unë punoj kam marrë pjesë në trajnime për praktikatat e higjenës së duarve.

#### **ne pavionin ku une punoj kam marre pjese ne trajnime per praktikatat e higjenes se duarve**

		Frequenza	Percentuale	Percentuale valida	Percentuale cumulativa
Valido	plotesisht jo dakord	37	37,0	37,0	37,0
	jo dakord	7	7,0	7,0	44,0
	deri diku dakord	23	23,0	23,0	67,0
	dakord	29	29,0	29,0	96,0
	plotesisht dakord	4	4,0	4,0	100,0
	Totale	100	100,0	100,0	

*Tabela 6: Pjesmarrja në trajnime*

Në bazë të të dhënave të paraqitura në tabelë marrim informacionin se 37% e infermierëve janë plotësisht jo dakord me faktin se ata marrin pjesë në trajnime për praktikatat e higjenës së duarve. 7% janë jo dakord. 23% janë deri diku dakord me pohimin se ata marrin pjesë në trajnime. 29% janë dakord se në pavionin ku ata punojnë trajnohen në lidhje me higjenën e duarve dhe vetëm 4% janë plotësisht dakord.



ne pavionin ku une punoj kam marre pjese ne trajnime per praktikat e higjenes se duarve

*Grafiku 4: Pjesmarrja në trajnime*


1b) Unë e di momentin kur kërkohet higjena e duarve.

**une e di momentin kur kerkoheh higjena e duarve**

		Frekuenza	Percentuale	Percentuale valida	Percentuale cumulativa
Valido	plotesisht jo dakord	12	12,0	12,0	12,0
	jo dakord	32	32,0	32,0	44,0
	deri diku dakord	21	21,0	21,0	65,0
	dakord	22	22,0	22,0	87,0
	plotesisht dakord	13	13,0	13,0	100,0
	Totale	100	100,0	100,0	

*Tabela 7: Njohuri mbi higjenën e duarve*

12% e infermierëve sipas informacionit që marrim nga tabela dhe grafiku shprehen se ata janë plotësisht jo dakord me faktin se ata e dinë momentin kur kërkohet higjena e duarve. 32% shprehen jo dakord, 21% janë deri diku dakord me faktin se ata e dinë momentin kur kërkohet higjena e duarve. 22% janë dakord dhe pjesa e mbetur përkatësisht 13% shprehen se janë plotësisht dakord.



*Grafiku 5: Njohuri mbi higjenën e duarve*

1c) Unë e realizoj me lehtësi higjenën e duarve.


**une e realizoj me lehtesi higjenen e duarve**

		Frequenza	Percentuale	Percentuale valida	Percentuale cumulativa
Valido	plotesisht jo dakord	22	22,0	22,0	22,0
	jo dakord	9	9,0	9,0	31,0
	deri diku dakord	28	28,0	28,0	59,0
	dakord	40	40,0	40,0	99,0
	plotesisht dakord	1	1,0	1,0	100,0
Totale		100	100,0	100,0	

*Tabela 8: Realizimi me lehtësi i higjenës së duarve*

Sipas rezultateve në tabelë dhe në grafikun e mëposhtëm shohim një diversitet në përgjigjet e dhëna prej infermierëve. 22% e infermierëve pohojnë se janë plotësisht jo dakord me faktin se ata e realizojnë me lehtësi higjenën e duarve, 9% janë jo dakord dhe 28% deri diku dakord. Këto të dhëna na lejojnë të interpretojmë se ndoshta ata nuk kanë kushtet e duhura për ta

realizuar këtë proces me lehtësi. Megjithatë pjesa më e madhe e infermierëve përkatësisht 40% shprehen se janë dakord me pohimin dhe 1% është plotësisht dakord.



*Grafiku 6: Realizimi me lehtësi i higjenes së duarve*

1d) Në pavionin tim e kam të lehtë ti përmbahem rekomandimeve të higjenes së duarve.


**ne pavionin tim e kam te lehte ti permbahem rekomandimeve te higjenes se duarve**

		Frequenza	Percentuale	Percentuale valida	Percentuale cumulativa
